



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Efiçienca e Energjisë në Kosovë 2011-2016





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Efiçienca e Energjisë në Kosovë 2011-2016



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Mars, 2018
© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për here të parë ka përgatitur publikimin "Efiçienca e energjisë në Kosovë " për periudhën 2011-2016.

Qëllimi i këtij publikimi është të paraqes treguesit e efiçencës së energjisë për sektorët e industrisë dhe ekonomive familjare.

Përgatitja e treguesve të efiçencës së energjisë në këta dy sektorë është realizuar sipas standardeve të Eurostat-it dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (IEA).

Rekomandimet e Eurostat-i dhe IEA-ja për treguesit e efiçencës së energjisë, kanë për qëllim krijimin e sistemit të treguesve statistikorë për vlerësimin e trendëve në fushën e efiçencës së energjisë.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura.

Ueb faqja: www.rks-gov.net/ask ose E-mail adresa: infoask@rks-gov.net

Publikimi u përgatit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Ilir T. Berisha – Drejtor i Departamentit

Ismail Sahiti – Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike

Bekim Bojku – Zyrtar

Sulltane Gashi – Zyrtare

Violeta Sylja – Zyrtare

Qendresa Shala – Zyrtare

Ahmet Cakolli – Zyrtar për dizajn

Mars, 2018

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Përmbajtja

	Faqe
Simbolet dhe Shkurtesat.....	4
1 Metodologjia dhe përkufizimet e koncepteve themelore.....	5
2 Treguesit e efikasitetit energjetik për ekonominë Kosovare dhe sektorët e saj.....	7
2.1. Dinamika e zhvillimit të ekonomisë	7
2.2. Konsumi i energjisë dhe çmimet e energjisë	7
2.3. Treguesit makroekonomikë	9
2.4. Konsumi final i energjisë në Industri	10
2.5. Konsumi final i energjisë në ekonomitë familjare	12
TABELAT.....	15

Simbolet dhe Shkurtesat

ASK- Agjencia e Statistikave të Kosovës

KEK- sh.a Korporata Energjetike e Kosovës

KEDS- Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike

REKOS Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011

EUROSTAT-Agjencia Evropiane e Statistikave

AIE- Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë

GWh - Giga Vat Orë

GW-Giga Vat

MWh - Mega Vat Orë

MW-Mega Vat

BPV-Bruto Produkti Vendor

toe - ton oil ekuivalent

Ktoe - Kilo ton oil ekuivalent

Mtoe - Mega ton oil ekuivalent

1 Metodologjia dhe përkufizimet e koncepteve themelore

Për përgatitjen e këtij publikimi janë shfrytëzuar këto burime:

rezultatet nga anketat, të dhënat nga burimet administrative dhe publikimet dhe studimet e ndryshme të ASK-së.

- rezultatet nga anketat statistikore – *Konsumi i energjisë në sektorin e industrisë për vitin 2014; Konsumi i energjisë në ekonomitë familjare për vitin 2015* dhe anketat e tjera të ASK-së,
- burimet administrative - *Të dhënat nga Korporata Energjetike e Kosovës, Kompania Kosovare për furnizim me energji elektrike dhe të dhënat nga ngrohtorja e Prishtinës, N.P. Termokos Sh.A. dhe*
- Publikime dhe studime tjera të ASK-së - *Regjistrimi i popullsisë 2011; Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit për periudhën 2011- 2016; Bilanci i energjisë në Kosovës (2011-2016); Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për periudhën 2011- 2016 dhe Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë për periudhën 2012-2016.*

Konsumi total i energjisë primare përfshin konsumin e burimeve primare të energjisë, si dhe rimëkëmbjen, bilancin tregtar, (-) bunkerët dhe ndryshimet e stokut të energjisë së nxjerrë sipas metodologjisë së Eurostat-it.

Të gjitha burimet e energjisë të cilat mund të gjenden në natyrën tonë dhe të cilat teknikisht nuk janë shndërruar – si fosili, energjitë gjeologjike ose të rinovueshme.

Konsumi final i energjisë nënkupton konsumin përfundimtar të energjisë për qëllimin e energjisë të llogaritur sipas metodologjisë së Eurostat / IEA.

Kursimet e energjisë i referohen shmangies së përdorimit të energjisë nga veprimet ose vendimet e caktuara.

Konsumi final në industri nuk përfshin sektorin e transformimit të energjisë. Transformimi në furrat e shpërthimit llogaritet duke përdorur efikasitetin e vërtetë të transformimit.

Intensiteti i energjisë primare të BPV -së është raporti i konsumit total të energjisë primare ndaj BPV-së.

Intensiteti final i energjisë së BPV -së është raporti i konsumit final të energjisë ndaj BPV -së. Intensiteti i energjisë së degëve është raporti i konsumit final të energjisë në këto industri me vlerën e shtuar të tyre.

Konsumi i energjisë në strukturë konstante llogaritet duke përdorur metodën Divisia në mënyrë të tillë që produkti i dinamikës së intensitetit të energjisë në strukturën konstante dhe efektin e ndryshimeve strukturore siguron dinamikën e intensitetit të energjisë. Efekti i ndryshimit strukturor u llogarit si shuma e ponderuar e ritmeve të rritjes së komponentëve individualë.

Normat e rritjes përcaktohen si logaritmi natyror i ndryshimit relativ të vlerës së shtuar të industrisë së përgjithshme në vitet në vijim dhe peshat janë pjesa e konsumit mesatar të energjisë në industri në konsumin e përgjithshëm në vitet pasuese.

Indeksi i efiçencës së energjisë (IEE) llogaritet duke bashkuar ndryshimet individuale të konsumit të energjisë, të vërejtura në nivele të caktuara të përdorimit përfundimtar. Indikatori i IEE nuk tregon nivelin aktual të intensitetit të energjisë, por përmirësimin e vitit bazë. IEE llogaritet për çdo vit si raporti i konsumit aktual të energjisë në një vit të caktuar dhe konsumi teorik i energjisë i cili nuk merr parasysh efektin individual (d.m.th. duke supozuar nivelin e mëparshëm të intensitetit të energjisë në proceset e prodhimit). Për të zvogëluar luhatjet e rastit, llogaritet një mesatare lëvizëse 3-vjeçare.

Rënia e vlerës së treguesit paraqet një rritje të efiçencës së energjisë.


Efiçienca e energjisë i referohet zvogëlimit të sasisë së energjisë së përdorur për shërbimin e caktuar ose nivelin e veprimtarisë në mënyrë që të prodhohet niveli i njëjtë i shërbimit përfundimtar. Përmirësimet e efiçences së energjisë kryesisht arrihen përmes përdorimit të pajisjeve teknologjike më të përparuara me efiçencë të lartë (poqët fluoreshente, pajisjet elektro-shtëpiake A++, etj.).

2 Treguesit e efikasitetit energjetik për ekonominë Kosovare dhe sektorët e saj

2.1. Dinamika e zhvillimit të ekonomisë

Produkti i Brendshëm Bruto (BPV) ishte vazhdimisht në rritje gjatë periudhës së paraqitur duke arritur në vitin 2016 me 31,5% vlera më të larta me çmime konstante se në vitin 2011.

Figura 1. Dinamika e treguesve bazë makroekonomikë (2011 = 100)




2.2. Konsumi i energjisë dhe çmimet e energjisë

Prodhimi total i energjisë primare ka pasur ngritje gjate periudhës 2011-2016 prej 1.793 Mtoe në 2.010 Mtoe rreth 12.12% (apo 2.4% në vit). Prodhimi ka tendencë të ulet deri në vitin 2014 (rënia më e madhe ka ndodhur në vitin 2014), kurse rritja ka filluar nga viti 2015, në vitin 2016 ka arritur 2.01 Mtoe.

Konsumi final i energjisë është rritur në periudhën e prezantuar nga 1.284 në 1.432 Mtoe, që do të thotë një normë mesatare vjetore rritjeje prej 2.3%. Ngritja e konsumit është regjistruar nga viti 2014.


Figura 2. Konsumi i përgjithshëm primar dhe final i energjisë në Mtoe



Burimet natyrore ekzistuese vendase kanë një ndikim të rëndësishëm në strukturën e energjentëve të përdorura në ekonomi. Burimi kryesor i energjisë primare është linjiti i cili merr pjesë me mbi 80%, druri është bartësi i dytë më i rëndësishëm i energjisë (13% në 2011 në 18% në vitin 2016).


Struktura e burimeve të energjisë në Kosovë për vitin 2011 dhe 2016 është paraqitur ne figurën nr. 3 .

Figura 3. Burimet e energjisë në Kosovë



Ne vitin 2016 në raport me vitin 2011, kemi rritje të energjisë së konsumuar për 11.52%. Industria ka ulje për 3.38% kurse rritjen më të madhe e kemi tek shërbimet 45.83% dhe bujqësia 42.93%

Figura 4. Konsumi përfundimtar i energjisë sipas sektorëve në ktoe




Çmimet e naftës gjatë periudhës 2011 - 2016 kanë shënuar ulje graduale nga viti në vit, ku në vitin 2011 çmimi për një litër naftë ishte 1.24 €/l kurse në vitin 2016 çmimi për litër naftë ishte 0.93 €/l, kemi një ulje të çmimit të naftës për rreth 25%.

Çmimet e benzinës gjatë periudhës 2011 - 2016 kanë shënuar po ashtu ulje graduale nga viti në vit, ku në vitin 2011 çmimi për një litër benzinë ishte 1.24 €/l kurse në vitin 2016 çmimi për litër ishte 0.98 €/l, kemi një ulje të çmimit të benzinës për rreth 21%.

Lëvizjet e çmimeve të naftës dhe benzinës për periudhën 2011-2016 janë paraqitur në figurën nr. 5

Figura 5. Çmimet e naftës dhe benzinës



2.3. Treguesit makroekonomikë


Prodhimi primar dhe Konsumi final i energjisë u rritën në vitin 2016 krahasuar me vitin 2011 për 12.12% respektivisht 11.52%.

Intensitetit i energjisë kishte ulje sistematike deri në vitin 2014, viti i vetëm kur ndodhi rritja e intensitetit të energjisë ishte viti 2015 dhe 2016. (Figura 6).

Ndryshimi i treguesve vjetor të intensitetit nga viti në vit për periudhën 2011 - 2016 është paraqitur në tabelën nr.1.


Tabela 1. Norma mesatare vjetore e ndryshimeve në treguesit e intensitetit të energjisë së BPV-së

Norma e rritjes	2012	2013	2014	2015	2016
Intensiteti primar i BPV-së	-0,43	-0,12	-0,52	0,16	0,25
Intensiteti finali BPV-së	-0,37	-0,16	0,00	-0,06	0,09

Figura 6. Intensiteti i energjisë së BPV-së

2.4. Konsumi final i energjisë në Industri

Konsumi final i energjisë në industri arriti vlerën më të lartë në vitin 2011, me 315.6 ktoe kurse vlerën më të ulët në vitin 2013, me 260.8 ktoe. Nga vitet 2014-2016 konsumi i energjisë në sektorin e industrisë ishte në rritje të vazhdueshme.

Figura 7. Konsumi final i energjisë në sektorin e industrisë

Struktura e konsumit të energjisë në prodhim është e dominuar nga sektorët industriale në vijim si : Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit; Industria e hekurit dhe çelikut; Industria e metaleve jo-ferrore dhe Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore. Rënia e pjesëmarrjes në konsumin e energjisë në krahasim me vitin 2011 u regjistrua nga Industria e ushqimit pijeve dhe duhanit për 38.9%, kurse rritja u reflektua te industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore për 38.5%.

Figura 8. Konsumi i energjisë në prodhim sipas degës




Figura 9. Krahasimi i konsumit të energjisë në prodhim sipas degëve






Figura 10. Intensiteti i energjisë në degët e industrisë energjetike intensive ktøe/milion



2.5. Konsumi final i energjisë në ekonomitë familjare


Konsumi final i energjisë në ekonomit familjare arriti në 38.55% në vitin 2016.

Fig. 11. Konsumi i energjisë nëpër sektore



Konsumi i energjisë për ekonomi familjare ka rënë në periudhën 2011-2014 me një normë mesatare prej 3.3% në vit (Figura 12), kurse në vitin 2015 dhe 2016 pati përsëri rritje të konsumit të energjisë në sektorin e ekonomive familjare.


Konsumi më i lartë u regjistrua në vitin 2016 me 1.78 toe dhe më i ulët në vitin 2014 me 1.53 toe / për ekonomi familjare.

Fig. 12. Konsumi i energjisë në ekonomitë familjare 2011 -2016**Tabela 2. Konsumi energjisë së nxehtësisë në sektorin e ekonomive familjare**

Vitet	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014	2014/2015	2015/2016
Konsumi ne Ekonomit familjare GWh	19,41	24,15	24,09	25,84	75,48	97,62
Konsumi ne Ekonomit familjare kWh/m ²	29,96	36,86	37,34	40,73	114,29	140,33

Konsumi i energjisë së nxehtësisë në ekonomitë familjare për m² gjithashtu ka të ngritje. Rritja e konsumit të energjisë së nxehtësisë në ekonomitë familjare ka ndodhur gjatë gjithë periudhës (2010/2011- 2015/2016), rritja me e madhe ishte në periudhën 2015/2016, ku konsumi ishte 140.33 kWh / m².


Figura 13. Konsumi i energjisë së nxehtësisë në ekonomitë familjare



Të dhënat për konsumin e energjisë elektrike në ekonomitë familjare nga viti 2011 deri ne vitin 2016 tregojnë për konsum konstantë me tendencë në ulje, në 2016 kemi një ulje prej 19.16% në krahasim me vitin 2011, po ashtu ulje kemi për 8.89% krahasuar me vitin 2015.

Figura 14 pasqyron trendët e konsumit te energjisë elektrike për ekonomit familjare përkatësisht konsumin e energjisë elektrike për koke banori.

Figura 14. Konsumi i energjisë elektrike në ekonomitë familjare



TABELAT

Tabela 3. Konsumi i energjisë dhe intensiteti i BPV-së

Nr.	Specifikim	Njësia	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	<i>Shuma primare e energjisë së konsumuar</i>	<i>mtoe</i>	0,806	0,747	0,744	0,762	0,760	0,841
2	<i>Energjia finale e konsumuar</i>	<i>mtoe</i>	0,316	0,273	0,261	0,280	0,282	0,289
3	<i>Intensiteti i energjisë primare</i>	<i>toe/BPV</i>	0,175	0,151	0,142	0,141	0,131	0,139
4	<i>Intensiteti final i energjisë</i>	<i>toe/BPV</i>	0,069	0,055	0,050	0,052	0,049	0,048

Tabela 4. Treguesit e efiçencës së energjisë në sektorin e amvisërive

Nr.	Specifikim	Njësia	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	<i>Konsumi i energjisë për ekonomi familjare</i>	<i>toe/E.K</i>	1,65	1,53	1,53	1,50	1,55	1,78
2	<i>Konsumi i ngrohjes për ekonomi familjare</i>	<i>GJ/E.K</i>	1,12	1,12	1,18	1,35	3,28	4,47
3	<i>Konsumi i energjisë elektrike për person</i>	<i>kWh/përsone</i>	1441	1352	1472	1402	1346	1194
4	<i>Konsumi i energjisë elektrike për ekonomi familjare</i>	<i>kWh/E.K</i>	4335	4056	3960	4071	4444	3380

Tabela 5. Treguesit e efiçencës së energjisë në sektorin e amvisërive

Nr.	Specifikim	Njësia	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	<i>Intensiteti i energjisë i vlerës së shtuar</i>	<i>toe/vleren e shtuar</i>	0,273	0,211	0,185	0,188	0,182	0,177
2	<i>Intensiteti i energjisë elektrike i vlerës së shtuar</i>	<i>MWh/vleren e shtuar</i>	1,115	0,970	0,888	0,882	0,885	0,643
3	<i>Konsumi i energjisë për punonjës</i>	<i>toe/punësuar</i>	9,728	7,310	7,539	8,323	8,121	8,261
4	<i>Konsumi i energjisë elektrike për 1 punonjës</i>	<i>kWh/punësuar</i>	39,696	33,606	36,279	38,963	39,381	29,937

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

621.31(496.51)“2011/2016”

Efiçienca e energjisë në Kosovë 2011-2016 / përgatiten Ilir
T. Berisha... et al. – Prishtinë : Agjencia e Statistikave të
Kosovës, 2018. – 17 f. : ilustr. ; 24 cm.

1.Berisha, Ilir T.

ISBN 978-9951-22-446-8

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministritë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë . Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-446-8

